



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.273/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët, Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, në seancën e panelit të mbajtur me 12.06.2014, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kështu që Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 6650 (gjashtëmijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 09.06.2014, nga LVV, me të cilën pretendohet se më datë 08.06.2014 në ora 15:11, edhe pse ka qene ditë e heshtjes zgjedhore, aktivistit të LVV Genc Sherifi në telefonin e tij i ka ardhur sms për të votuar Adem Grabovcin kandidat për deputet i subjektit politik PDK.

LDK pretendon se me këtë veprim PDK ka bërë shkelje të nenit 7 paragrafi 7.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore nr.11/2013, Kodi i mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, Nenit 36.1 të pikës b të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotografi si dëshmi, në të cilat shihet dërgimi i mesazhit nga subjekti politik PDK. Parashtruesi i ankesës propozon që ndaj subjektit politik të lartë përmendur të ndërmerren masa ligjore në pajtim me LZP.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 10.06.2014, informoi subjektin politik PDK, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet në ankesë deri më datë 11.06.2014, deri në ora 12:00.

PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK, por përgjigja e ofruar nga subjekti politik PDK nuk ka të bëjë me kërkesën për përgjigje në ankesë që ka kërkuar PZAP-i sepse në përgjigjen e ofruar nga ky subjekt flitet për vendosjen e posterave mbi rrugë publike për të cilët nuk ka të bëjë ankesa në fjalë.

Veprimet e Ndaluar Para Procesit të Votimit – përcaktohen bazuar në Nenin 36.1 të LZP-së dhe Nenin 7.1 të Rregullës Zgjedhore 11/2013 në të cilat specifikohet se :

Njëzetekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë:

- a) shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, ose 100 metra brenda hapësirës së të njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi tek votuesit;*
- b) bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.*

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:

c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i pasi që shqyrtoi dhe analizoi ankesën dhe shkresat e lëndës gjeti se;

- ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se padyshim subjekti politik PDK, ka thyer heshtjen zgjedhore, në mënyrën siç pretendohet në ankesë. Një gjë e tillë shihet nga fotografia e telefonit dhe sms-i në telefonin e ankuesit, nga i cili rezulton se kandidati i PDK-së Adem Grabovci ka dërguar gjatë heshtjes zgjedhore sms me këtë përmbajtje: Voto PDK voto Adem Grabovcin nr 32. Sms-i është dërguar tek Genc Sherifi në ora 15:11 të datës 08.06.2014.

Bazuar në nenin 120 par. 1 pika (c), të LZP-së, përcaktohet qartë se në rast se ka ndodhur shkelja e këtij ligji ose rregullave të KQZ-së, PZAP-i mund të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në lartësi deri në 50.000 euro. Sipas Rregullës

Nr.01/2012 për “Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave”, neni 6 par.2 specifikon se “në qoftë se subjekti politik , mbështetësit ose kandidatët e tij bëjnë fushatë në çfarëdo mënyre 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës e deri në mbylljen e tyre subjekti politik që është i përfaqësuar në kuvendin e Republikës së Kosovës dënohet me gjobë nga 6500 euro deri në 25000 euro”.

Duke marr parasysh se subjekti politik i lart përmendur, në këto zgjedhje për të dytën herë radhazi ka bërë shkeljen e njëjtë duke thyer heshtjen zgjedhore në mënyrën e lartpërmendur, kjo rrethanë pa tjetër ndikon në lartësinë e gjobës së shqiptuar , PZAP-i, duke vlerësuar edhe rrethanat tjera të lartpërmendura, të njëjti subjekt i shqiptoi gjobën e lart cekur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prandaj nga arsyet e lartcekura, ne kuptim te nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 273/2014 më datën 12.06.2014

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.1 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.